

ARSIMI I LARTË NË SHQIPËRI (PROMEMORIA “MALËSHOVA”, 1946)

Çlirim DURO

E-mail: clirimduro@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Ky punim kërkon të hedhë sadopak dritë mbi punën titanike që bënë profesorët tanë në vitet e para të pas luftës, për të ngritur arsimin e lartë në Shqipëri. Punë që u kurorëzua me krijimin e Institutit të Lartë Pedagogjik, si institucioni i parë i arsimit të lartë në vendin tonë. Një nga profesorët që ze një vend të veçantë në këtë mision kaq të lartë është dhe Sejfulla Malëshova i cili në cilësinë e tij si ministër i arsimit paraqiti më 19 nëntor 1946 një promemorje, me anën e së cilës argumentoi në mënyrë shteruese nevojën e ngritjes së arsimit të lartë dhe shprehu pikpamjen e tij se si do të ishte ky arsim, si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

Në historiografinë shqiptare të periudhës komuniste ky fakt është anashkaluar me qëllim të pastër politik. Si përfundim mund të them se Prof. Sejfulla Malëshova mund të quhet ndryshe dhe themeluesi i Arsimit të Lartë në Shqipëri.

Fjalë kyçe: *arsimi i lartë, promemorje, Instituti Pedagogjik, Sejfulla Malëshova.*

HYRJE

Baza e këtij studimi është puna kërkimore në arkivin e shtetit shqiptar në disa fonde si: Fondi i Ministrisë së Arsimit, Fondi i Kryeministrisë, Fondi i Komitetit Qendror dhe Byrosë Politike të PPSH-së. Një artikull me temë *Higher Education in*

Albania u botua në periodikun e European Association for International Education (EAIE) më 2007. Objektivi i këtij shkrimi është të pasqyrojë punën e madhe që është bërë për të realizuar arsimin e lartë në Shqipëri. Arsyet e ndërmarrjes së këtij studimi janë ato të realizimit të tezës së Masterit: “Arsimi i lartë në Shqipëri”.

Në përpjekjen titanike për eliminimin e shpejtë të analfabetizmit, profesorati arsimor i kohës e drejtoi vëmendjen edhe në perspektivat e afërta të zhvillimit të vendit. Një gjë të tillë ai e lidhi ngushtë me nevojën e krijimit të arsimit të lartë dhe përgatitjen e kadrove të larta në shërbim të emancipimit të gjithanshëm të vendit. Edhe pse në realitetin historik të Shqipërisë së pasluftës nuk ekzistonte asnjë infrastrukturë në shërbim të tij, përsëri intelektualët e arsimit i hodhën sytë nga krijimi i themeleve të këtij sistemi arsimor. Në shërbim të hedhjes së themeleve të arsimit të lartë, një kontribut të veçantë ka dhënë Prof. Sejfulla Malëshova.

Ai mbetet një nga figurat qendrore historike të Luftës Antifashiste të popullit tonë. Për zotësitë e veta intelektuale e pikpamjet antifashiste ai arriti deri në strukturat e larta të kësaj lufte¹. Po ashtu S. Malëshova u zgjodh dhe në organet më të larta partiake dhe ishte ndër të rrallët që gëzonte një formim të plotë teorik e politik. E ndihmonte edhe fakti që studimet e larta i kishte kryer jashtë ven-

dit në degën e filozofisë² (në Universitetin e Lomonosovit, BS).

Nga tetori 1944 – shkurt 1946 ai bënte pjesë ne Byronë Politike të PKS-së që ishte organi më i lartë ekzekutiv i saj³. Pikërisht pjesëmarrja në forumet e larta partiake i krijoi mundësi të shpaloste me forcë mendimet e veta politike, të cilat do ti kushtonin deri në ndërprerjen e karrierës politike e shkencore. Gjatë kësaj kohe ai u bë një protagonist i mendimit politik dhe vështirë se mund të gesh ngjarje të kohës që të mos lidhen më emrin e tij. S. Malëshova ishte ndër të vetmit që parashtroi publikisht një platformë politike alternative në udhëheqjen e lartë komuniste. Thelbin e platformës e përbën teoria e ashtuquajtur e “gradualitetit politik” ose e respektimit të etapave të revolucionit. Sipas tij reformat e ndërmarrja në jetën e vendit duhet t’i nënshtroheshin kushteve dhe mundësive konkrete. Teorikisht, theksonte S. Malëshova, komunistët e kanë marrë pushtetin, prandaj nuk duhet të friksohen nga ekzistenca për një kohë e pronarëve të mëdhenj. Përkundrazi, sipas tij prona e madhe do të mund të përballonte më mirë nevojat ekonomike të njerëzve⁴.

Me këto pikpamje S. Malëshova, nuk i kundërvihej sistemit komunist. Përkundrazi, në të gjitha shkrimet e diskutimet e veta politike ai theksonte se mbetet komunist në bindje. E vetmja gjë që kundërshtoi në reformat e para ishte ritmi tejte i shpejtë i tyre. Fjala ishte sidomos për reformat ekonomike e mbi te gjitha për reformën e shtetëzimeve socialiste. Me këto qëndrime ai iu kundërvu vijës politike të krahut ekstremist në PKS të përfaqësuar nga Enver Hoxha. Ky krah i konsideroi si antidemokratike, madje dhe antikombëtare, pikpamjet e tij. Në një plenum partiak të mbajtur në shkurt të vitit 1946, E. Hoxha u bëri gjyq mendimeve të S. Malëshovës, duke i etiketuar ato si “oportuniste”, “liberale” etj. Sipas tij ato mbartnin me vete një rrezik të madh për vendin, pasi synonin rivendosjen në Shqipëri të një regjimi të demokracisë perëndimore⁵. Me këto motive S. Malëshova u përjashtua nga të gjitha postet e larta partiake, dhe nga partia.

Pavarësisht nga goditja e madhe që mori, ai nuk e ndërpreu punën në shërbim të vendit. Në qeverinë e parë komuniste që doli nga zgjedhjet e vitit 1945, me mandat nga marsi 1946, S. Malësho-

va mori portofolin e Minsitrit të Arsimit e të Kulturës⁶. Kjo sepse edhe dënimet e dhëna preknin vetëm funksionet partiake dhe jo ato shtetërore. Qënie në krye të këtij dikasteri e shfrytëzoi në funksion të përmbushjes së detyrimeve kombëtare për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës. Këto detyrime ai i lidhi ngushtë me realizimin e ëndrrës së vjetër të rilindasve për krijimin e arsimit të lartë. I përkushtuar tërësisht në përmbushjen e detyrës, S. Malëshova hodhi hapin e parë në këtë drejtim.

Prof S. Malëshova ishte i pari intelektual në Shqipëri që ideoi, në përputhje me kushtet e vendit, një projekt për krijimin e një Instituti Pedagogjik në Shqipëri. Më 19 nëntor 1946 ai i paraqiti qeverisë një memorie, me anën e së cilës argumentoi në mënyrë shteruese nevojën e ngritjes së kësaj hallke mësimore⁷. Në historiografinë shqiptare të periudhës komuniste ky fakt është anashkaluar me qëllime të pastra politike pasi jo vetëm tekstet akademike, por edhe ato monografike, nuk japin asnjë vlerësim, aq më keq, nuk përmendin fare rolin e S. Malëshovës. Edhe pse preket shkarazi kjo ngjarje, minimizohet tej mase roli dhe vlerat e saj për arsimin e lartë në Shqipëri⁸. Pavarësisht se ky Institut nuk i gëzonte të gjitha atributet e një hallke arsimore të lartë, në përgjithësi ai plotësonte disa nga kriteret kryesore të tij, për më tepër ai përmbushte disa nga kërkesat emergjente që shtronte shkolla për kuadro mësimdhënës.

Për të justifikuar arsyet e ngritjes së këtij instituti, promemoria përcaktoi qartë që në fillim qëllimin e tij. “Instituti pedagogjik, theksonte ajo, do të përgatisë mësues për shkollat unike”, për të kaluar më pas në mësues për shkollat e mesme (normale dhe liceale)⁹. Shkolla unike quheshin shkollat e ciklit fillor. Instituti do të diplomonte mësues në dy degë, ose fakultete siç i emëronte promemoria: degën e letrave dhe degën e shkencës. Studentët e institutit i nënshtroheshin një programi mësimor të ngjeshur dhe me lëndë të shumta pa shumë afërsi studimi. Por ai ishte mjaft i përshtatshëm për specializimin e mësuesëve të shkollave të ulta. Kështu, studentët e fakultetit të letrave do të specializoheshin për gjuhë shqipe, histori, gjeografi, kurse ata të fakultetit të shkencave për matematikë, fizikë, kimi, shkencë natyre. Të dy fakultetet kishin një numër lëndësh të përbashkëta, kryesisht

të formimit të përgjithshëm, filozofik e profesional (mësimdhënës). Lëndët e përbashkëta ishin: filozofi, pedagogji, gjuhë e huaj (rusisht), latinisht, kulturë ushtarake, histori arti, higjenë, edukatë fizike dhe këngë. Programi përmbante praktika mësimore (hospitime siç i quante ai)¹⁰. Lënda e latinishtes, konsiderohej e domosdoshme për mësimin e gjuhës shqipe. Programi parashikonte edhe disa kurse speciale, sidomos për historinë e Shqipërisë dhe gjuhën shqipe.

Ky program mësimor, sipas promemories kishte qëllim të dyfishtë: nga njëra anë ndihmonte mësuesit të përvetësonin mirë përmbajtjen e lëndëve të shkollës unike, nga ana tjetër, më vonë me specializime plus, me zgjerimin e kulturës universitare këta mësues do të profilizoheshin për shkollat e mesme¹¹. Të gjitha lëndët ishin semestrale dhe do të shlyheshin me provim.

Promemoria përcaktonte qartë edhe kriteret e pranimit të studentëve në Institut. Sipas saj, atje do të pranoheshin vetëm nxënësit që kishin arsim të mesëm (normale ose lice) sepse në Institut do të zhvilloheshin mësimet të kulturës së lartë, pra lëndët mësimore kishin status universitar, pavarësisht, theksonte ajo se kjo kulturë nuk ishte "kryekëput kulturë e plotë universitare". Shkak bëhej specializimi jo i ngushtë i studentëve¹². Megjithatë, promemoria theksonte se specializimi në disa lëndë të kulturës kombëtare duhej parë më me kujdes. Për këto shkenca, vërente ajo (gjuhë e letërsi shqipe) do të jepej maksimumi i literaturës që ekzistonte në vendin tonë deri atëherë. Këtë lloj specializmi studentët nuk mund ta arrinin as jashtë vendit prandaj ata mbeteshin kapaciteti i vetëm intelektual për mësimdhënien e këtyre lëndëve, deri dhe në shkollat e arsimit të mesëm. Ndërsa, për disa lëndë të tjera (histori, gjeografi) ku mungonte tërësisht literatura, nuk do të synoheshin nivele të barabarta me të tjerat¹³.

Afatet e studimeve në Institut ishin dy vjet. Në një perspektivë të afërt mendohej të kthehej në 4-vjeçar. Çdo vit mësimor ndahej në dy simestre, me nga 4 muaj mësim dhe dy javë provim secili. Për dy vitet e para, instituti do të punonte më një strukturë mësimore që mbante parasysh situatat e jashtëzakonshme të pasluftës. U mendua që viti i parë të fillonte studimet në dhjetor 1946¹⁴.

Në promemorieje i kushtohej vëmendje edhe profesoriatit të Institutit. Pjesën më të madhe të pedagogëve e përbënin figurat më të njohura të botës intelektuale shqiptare. Vetëm një numër i kufizuar syresh u mendua të mbulohej me pedagogë të huaj që jepnin gjuhën e huaj. Kështu në shërbim të Institutit u vunë emra të njohur që hodhën edhe themelet e arsimit universitar shqiptar. Drejtor i Institutit Pedagogjik dyvjeçar u caktua Prof. Dh. Shuteriqi, i cili do të mbulonte të gjitha lëndët e letërsisë shqipe e të huaj. Më tej titullarët kryesorë të lëndëve ishin: Prof. S. Malëshova, filozofi, pedagogji e psikologji; Prof. Dh. Xhuvani, gjuhësi; Prof. A. Buda dhe Prof. Sh. Musaraj, histori; Prof. P. Geço, gjeografi; Prof. A. Tashko matematikë; Prof. K. Popa, kimi e shkenca të natyrës; Prof. H. Sulçebaj, higjenë dhe Prof. L. Shala edukatë fizike¹⁵. Praktikat mësimore do të udhëhiqte çdo pedagog lënde.

Instituti Pedagogjik do të fillonte veprimtarinë e vet me 70 studentë të sistemit me shkëputje nga puna. U parashikua që instituti të pranonte edhe një kontigjent studentësh pa shkëputje nga puna. Secili student i rregullt përfitonte nga shteti edhe një bursë mujore të llogaritur në 140 franga. Në vitin e parë studentët duhet të përballonin vetë shpenzimet e strehimit e të fjetjes.

Në fund, promemoria theksonte se hapja e Institutit Pedagogjik nuk ishte parashikuar në buxhetin vjetor të shtetit. U mendua që shpenzimet e këtij viti të mbuloheshin nga fondi për mirëmbajtjen dhe merementimin e shkollave¹⁶.

Për herë të parë mësimet filluan në dhjetor 1946. Për shkak të situatave viti i parë akademik u zhvillua në kushte shumë të vështira. Përvojës së pakët dhe nivelit të ulët të kuadrove të para, i shtohej edhe mungesa e infrastrukturës së lartë arsimore plus vështirësitë e gjithanshme të krizës së pasluftës. Si godinë mësimore u përdorën mjediset shkencore të Institutit të Studimeve, i cili e filloi veprimtarinë e vet në vitin 1947¹⁷. Ky ishte institucioni i parë më karakter shkencor që u çel në Shqipëri. Ai kishte si qëllim që të përballonte detyrat për zhvillimin e shpejtë ekonomik e kuturor të vendit por këto detyra u përcaktuan më qartë në prill të këtij viti nga Asambleja e Përgjithëshme e Institutit¹⁸. Kjo mbledhje piketoi disa nga pikat urgjente

përpara punonjësve shkencorë të Institutit. Ndër to më kryesore ishin: mbledhja e fakteve dhe krijimi i arkivit, fillimi i studimeve për shfytëzimin e pasurive natyrore, mbiotkësore e nëntoksore, fillimi i studimeve për eliminimin dhe parandalimin e disa sëmundjeve infektive, hartimi i fjalorit të gjuhës shqipe, organizimi i një pune sistematike për studimin e problemeve të gjuhës, historisë dhe kulturës kombëtare¹⁹. Detyrë parësore, Instituti i Studimeve konsideroi edhe përkthimin dhe botimin e veprave shkencore të autorëve të huaj. Mbi të gjitha kujdesi do të përqëndrohej në botimin e veprave të klasikëve të marksizëm-leninizmit, siç i emërtonte buletini i tij shkencor. Botimi u trajtua si një nevojë e domosdoshme, në funksion të krijimit të bazës teorike e metodologjike të veprimtarive shkencore. Teoria marksiste, pra do të shërbente si një kundërvënie për të gjitha shkollat e tjera teorike, që për fat të keq u cilësuan antipërparimtare, deri dhe reaksionare. Ja se si shprehet buletini i parë shkencor i Institutit: “Njerëzit e kulturës, të shkencës dhe të artit në Shqipëri, duke përvetësuar këtë metodë, do t’i përvishen përfundimisht luftës kundër ideologjisë së vjetër për të realizuar me sukses... nevojat e kulturës sonë të re”²⁰. Përdorimi i metodës e i teorisë marksiste në funksion të tendenciozitetit klasor ideologjik dhe të luftës politike nga pozita klasore u sanksionua si platformë zyrtare e politikave shkencore të udhëheqjes komuniste. Kjo platformë është zberthyer herë pas here nga vetë lideri komunist Enver Hoxha në forume e ngjarje të ndryshme partiake. “Botkuptimi materialist i botës, theksonte ai në vitin 1947, filozofia materialiste, materializmi dialektik dhe historik, këto dhe vetëm këto duhet të jenë bazat shkencore që do të bëjnë të përparojë shkenca dhe kultura në vendin tonë”²¹. Mbështetur në këtë platformë politike, jo rrallë studimet tona shkencore, sidomos ato me karakter shoqëror e shkencor, vuanin nga njëanshmëria, politizimi dhe cënimi i objektivitetit shkencor. Mbi bazën e saj politike, në këtë kohë filluan të botohen e përkthehen me shpejtësi vepra të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit që cilësoheshin në politikën zyrtare si klasikë të mëdhenj dhe krijues të shkollës materialiste dialektike. Të tilla vepra të konsideruara fundamentale ishin *Manifesti i Partisë Komuniste*, *Kapitali*, *Historia e PKBS-së*, etj.

Gjithësesi, hapja e Institutit Pedagogjik dy vjeçar dhe atij të Studimeve, përpos që plotësuan një ëndërr shekullore të dijetarëve shqiptarë, i hapën rrugën një hallke të re shkollore, arsimit universitar. Me këto ngjarje u mbyll tërësisht cikli i sistemit arsimor shqiptar. Në rregulloren e brendëshme të Institutit Pedagogjik, të hartuar në vitin 1947, thuhej: “Institutit Pedagogjik i Tiranës është një shkollë studimesh të nalta, me karakter universitar, që përgatit dhe nxjerr mësues për shkollat unike të Republikës Popullore të Shqipërisë”²². Natyrisht, arritja e këtij suksesi ishte meritë e intelektualëve të kohës, por jo pak rol luajtën edhe politikat afatgjata arsimore të regjimit komunist. Merita më e madhe padyshim i takon prof. Sejfulla Malëshovës (këtij ish profesori të Fakultetit të filozofisë në Universitetin e Lomonosovit) që mund të quhet ndryshe dhe themelesi i arsimit të lartë në Shqipëri.

BIBLIOGRAFIA

1. *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, Tiranë 1984, f. 52.
2. HOXHA, E. *Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re*, f. 181; AQSH, f. 14, viti 1947, dos. 14, dos. 16, 6; AQSH, f. 890, viti 1946, dos. 4. f. 5.
3. PPSH, *Dokumente Kryesore*, Vëll I, Tiranë 1961, f. 24.
4. AQSH, f. 490, viti 1947, dos. 14, fl. 18, 19, 20, 21, 22; *Historia e Shqipërisë*, Vëll. IV, Tiranë 1984, f. 39; *Historia e PPSH*, Tiranë 1980, f.28.
5. HOXHA, E. *Vepra*, Vëll. V, Tiranë 1971, f. 45.
6. AQSH, f. 890, viti 1946, dos. 4. f. 5.
7. AQSH, F. 1011, viti 1946, dos. 14, fl. 2, Promemoria 2657, “Mi krijimin në Tiranë, këtë vit të një Institutit Pedagogjik”. Tiranë, 17 gusht 1947.
8. KAMBO, E. *Zhvillimi i Revolucionit Kulturor në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948*, vepër e cituar f. 72-74; *Historia e Shqipërisë* Vëll. IV, Tiranë 1984, f. 82.
9. Universiteti i Tiranës Enver Hoxha, Tiranë, 1985, f. 8.
10. AQSH, F. 1011, viti 1946, dos. 14, fl. 2.
11. AQSH, F. 1011, viti 1946, dos. 14, fl. 2.
12. AQSH, F. 1011, viti 1946, dos. 14, fl. 2.
13. AQSH, F. 1011, viti 1946, dos. 14, fl. 2.
14. AQSH, F. 1011, viti 1946, dos. 14, fl. 2.
15. AQSH, F. 1011, viti 1946, dos. 14, fl. 2.
16. AQSH, F. 1011, viti 1946, dos. 14, fl. 2.
17. AQSH, f. 890, viti 1947, dos. 267. f. 1. Vendim i këshillit të Ministrave Nr, 1. dt. 28, viti 1947.
18. KAMBO, E. *Zhvillimi i Revolucionit Kulturor në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948*, vepër e cituar f. 126.
19. *Buletin i Institutit të Studimeve*, n. 1, 1947, f. 47-50.
20. *Buletin i Institutit të Studimeve*, n. 1, 1947, f. 67-68.
21. *Historia e Shqipërisë*, V. IV, Tiranë 1984, f. 346-347.
22. AQSH, f. 1011, viti 1947, dos. 38, f. 2.